



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 351/7 prot.

Tiranë, 14.9.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 60, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Gentian Medja
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 31.8.2018, është njoftuar vendimi nr. 60, datë 1.8.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Gentian Medja, magjistrat/gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Më datë 9.8.2018, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 60, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja, nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të ONM-së.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga dita e njoftimit.

Brenda këtij afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 60, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit z. Gentian Medja, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (ish-anëtar zëvendësues i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi), i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe përkohësisht edhe të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër nga viti 2004 deri në nëntor të vitit 2013 dhe aktualisht është gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

3. Me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procesin e rivlerësimit, referuar nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit mbi të tria kriteret, atë të pasurisë, figurës dhe profesional, ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në datë 6.12.2017 dhe ka përfunduar më datë 11.7.2018.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*referuar në vijim si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit (*referuar në vijim si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*referuar në vijim si Inspektorati*), nga të cilat ka rezultuar se:

4.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33/5 të ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gentian Medja¹”, i ka referuar Komisionit se:

- i. Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

4.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit², i ka referuar Komisionit:

- i. përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.

4.3 Për kriterin profesional, Komisioni ka thelluar hetimin administrativ, ku përveç tri dokumenteve ligjore (vendime gjyqësore), dorëzuara nga subjekti, dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short (shtojca 4 e ligjit nr. 84/2016), ka vlerësuar dhe përzgjedhur edhe pesë dosje gjyqësore shtesë³, të cilat i janë dërguar për analizë Inspektoratit. Inspektorati, bazuar në nenin 43/2 të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit (dy⁴) raportet e hartuara për aftësitë profesionale të subjektit, si dhe raport vlerësimi mbi një dosje gjyqësore të subjektit, për një rast të denoncuar pranë Komisionit nga shtetasi ***.***.

¹ Protokolluar pranë KPK-së, me nr. *** prot., datë ***.11.2017.

² Protokolluar pranë KPK-së me nr. *** prot., datë ***.11.2017.

³ Të përzgjedhura nga tabelat statistikore të paraqitura nga KLD-ja.

⁴ Raporti i parë me nr. *** prot., datë ***.1.2018 dhe i dyti, protokolluar me nr. ***, datë ***.4.2018.

5. Më datë 11.7.2018, trupi gjykues i Komisionit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, ka vendosur:

- i. Përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e kontrollit;
- ii. Njoftimin e subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara për të tria kriteret kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe kalimin e barrës së provës mbi gjetjet lidhur me aftësinë profesionale;
- iii. Njoftimin e subjektit për t'u njohur me dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, me qëllim ushtrimin e të drejtave të tij, referuar neneve 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Pas administrimit të pretendimeve të subjektit dhe provave të dorëzuara prej tij, Komisioni ka vendosur të ftojë subjektin z. Gentian Medja në seancë dëgjimore, zhvilluar më datë 30.7.2018.

II. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, nenit Ç, pika 1, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin z. Gentian Medja ka përfshirë kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli janë si vijon:

7.1 Për vlerësimin e pasurisë. Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni pas administrimit të raportit dhe materialeve përkatëse nga ILDKPKI-ja, ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjekte të së drejtës publike dhe ato private⁵, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit nuk kanë rezultuar pasaktësi në deklarime, likuiditete të pajustificuara, deklaram të rremë apo fshehje pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit.

7.2 Për kontrollin e figurës. Nga hetimi administrativ nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit është gjetur në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

7.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pasi ka administruar dy raportet e përgatitur nga Inspektorati, analizimit të 13 çështjeve gjyqësore (10 të përzgjedhura me short dhe 3 të paraqitura nga subjekti) dhe vlerësimit të 2-të⁶ (nga 5 të depozituara) denoncimeve nga publiku, për subjektin z. Gentian Medja ka listuar gjetjet si vijon:

i) mosrespektimi në mënyrë të përsëritur i afateve në gjykimin e çështjeve;

⁵ Gjatë hetimit administrativ nga ana e KPK-së janë administruar prova/akte nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. etj.

⁶ Sipas arsyetimit të Komisionit - f.17 e vendimit, për subjektin e rivlerësimit është vlerësuar informacioni i marrë nga dy denoncime që përmbushin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

- ii) mungesë në mënyrë të përsëritur e veprimeve për thirrjen apo shtyrjen e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, duke mos u lëshuar vendime të ndërmjetme apo urdhra nga ana e gjyqtarit;
- iii) mungesë e procesverbaleve të mbajtura nga sekretaria gjyqësore;
- iv) parregullsi gjatë veprimeve përgatitore në mënyrën e njoftimit të palëve etj.;
- v) referenca të gabuara në vendim të dispozitave ligjore.

7.3.1 Pas kalimit të barrës së provës dhe administrimit të pretendimeve të subjektit mbi gjetjet e sipërcituara (f. 28-29 e vendimit), shumica e Komisionit, e bazuar në aneksin e Kushtetutës, neni E, pika 1 (në lidhje me aplikimin e nenit 61/4⁷ apo nenit 58/1/b⁸ të ligjit nr. 84/2016), ligjin nr. 96/2016 (nenet 72-76) dhe ligjin nr. 84/2016 (neni 44), ka argumentuar se:

- *subjekti ka pasur një ngarkesë të lartë në punë (sa trefishi i ngarkesës mesatare për një gjyqtar), fakt i vërtetuar nga të dhënat statistikore të KLD-së, prapësimet dhe dokumentet e dorëzuara nga subjekti më datë 23.7.2018, si dhe faktin e njohur botërisht mbi ngarkesën e punës në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, që nga momenti i krijimit të saj në vitin 2013, e në vazhdim, ku çështjet e pagjykuara kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të mbartura vit pas viti;*

- *subjekti rrëzoi disa nga parregullsitë procedurale të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit. Mangësitë nuk vërtetojnë që subjekti ka njohuri, aftësi në gjykim, qëndrime ose modele pune aq të dobëta, sa të kenë rrezikuar dhe cenuar të drejtat e qytetarëve. Në asnjë nga çështjet e verifikuara nuk vërtetohet që këto parregullsi të jenë bërë pengesë në mbarëvajtjen e procesit, si dhe subjekti të ketë shkelur të drejtat e palëve në proces (neni E, pika 5 e aneksit të Kushtetutës);*

- *për sa i përket afateve të gjykimit, subjekti ka detyrimin për të vepruar sipas ligjit nr. 49/2012, i cili ka parashikuar një afat të arsyeshëm për gjykimin e çështjeve administrative, pa përcaktuar një afat konkret;*

- *për sa i përket shtyrjes së afateve gjatë gjykimit të çështjeve, është e vërtetë se kjo mund të konsiderohet e barasvlershme me një “mosdhënie drejtësie”. Në rastin e subjektit, nisur nga të gjitha sa më sipër, por edhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, duke pasur në konsideratë vlerësimin e pasurive, vlerësimin e figurës së subjektit, numrin e paktë të denoncimeve, nuk vërtetohet që ky paralelizim të jetë i vërtetë. Përpos kësaj, “mosdhënia e drejtësisë” do të kishte reflektuar sadopak në vlerën pasurore të aseteve të tij apo etikën dhe pastërtinë e figurës, për të cilat nuk kanë rezultuar ankesa apo të dhëna negative nga burime të çdo lloji qofshin;*

- *duke marrë në konsideratë se një nga qëllimet e ligjit nr. 84/2016 është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, konstatohet se në rastin e subjektit të rivlerësimit nuk ka elementë që tregojnë se ai ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*

7.3.2 Sipas këtij arsyetimi të shumicës së trupit gjykues, mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit nuk janë të tilla sa ai të konsiderohet i papërshtatshëm (pika 4 dhe 5 e nenit E e aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 4 e ligjit) apo të tilla që të mundësohet rikuperimi me program trajnimi (pika 3 e nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe neni 60, pika 1 e ligjit).

7.3.4 Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi relatorja e çështjes ka propozuar që subjekti i rivlerësimit të vlerësohet

⁷ Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore ... kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.

⁸ Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit... pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

“i aftë”, shumica e trupit gjykues ka krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe për këto arsye konsiderohet “i aftë”.

7.4 Shumica e trupit gjykues i Komisionit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, dhe me shumicë votash, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

- i. *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Medja, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë;*
- ii. *Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016;*
- iii. *Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

7.5 Ndërkohë, mbi të njëjtat gjetje dhe prova, pakica e trupit gjykues, duke i konsideruar mangësitë e vërejtura në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit të tilla që nuk mund të riparohen as nëpërmjet detyrimit për ndjekjen e programit trajnues të Shkollës së Magjistraturës, ka qenë e qëndrimit për të shkarkuar nga detyra z. Gentian Medja, për shkak të mungesës së aftësive profesionale.

III. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM)

8. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “C⁹”, e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65/2,¹⁰ të ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 9.8.2018, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr.***, “*Rekomandim për paraqitje ankimi*” ndaj vendimit nr. 60, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja (bashkëlidhur këtij ankimi).

8.1 Objekti i këtij rekomandimi, lidhet vetëm me vlerësimin dhe përfundimet e Komisionit për kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, në mënyrë të përmbledhur, bazohet në këto elemente:

8.1.1 **Arsyet për apelin e vendimit.** Sipas rekomandimit të ONM-së (pika 4), shkaqet për paraqitjen e një apeli kundër vendimit nr. 60, datë 1.8.2018, të Komisionit janë:

8.1.1a. Rezultatet. Ka dyshime nëse vlerësimi i shumicës “i aftë” për subjektin e rivlerësimit është i përshtatshëm duke pasur parasysh faktet e këtij rasti. Siç përshkruhet në opinion, bashkëlidhur rekomandimit, ka rezultuar se mangësitë profesionale të konstatuara në 13

⁹ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

¹⁰ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

çështjet e përzgjedhura për subjektin e rivlerësimit, paraqiten si “model”, fakt i cili mund të nënkuptojë se ato janë të natyrës strukturore të vazhdueshme. Në këndvështrimin e ONM-së, këto mangësi nuk mund të klasifikohen automatikisht si thjesht “minore”/të vogla.

8.1.1.b Arsyetimi. Vlerësimi “i aftë” justifikohet me ngarkesën e punës së subjektit të rivlerësimit. Argument ky i përdorur nga subjekti, paraqitur si thelbësor edhe në arsyetimin e Komisionit. Referuar edhe opinionit, ky argument nuk është bindës pa prova të mëtjeshme, pasi ngarkesa në punë e subjektit nuk është në mënyrë substanciale më e lartë se mesatarja¹¹. Për më tepër, koncepti “i proporcionalitetit” duket sikur luan një rol në arsyetimin e vendimit, më e pakta, në krijimin e “bindjes së brendshme” të shumicës së trupit gjykues. Por kjo është e diskutueshme, nëse ka vend, duke pasur parasysh kuadrin ligjor, të zbatohet ky parim për të shmangur një rezultat negativ të vlerësimit të aftësisë, rezultat i cili justifikohet nga faktet. Duhet vlerësuar gjithashtu se Komisioni argumenton se edhe për subjekte të tjera, mangësi të ngjashme janë gjetur. Pa ofruar asnjë sqarim të mëtjeshëm mbi këtë çështje, është e vështirë të kuptosh vlerën e këtij arsyetimi.

8.1.1c Çështje ligjore. Në përgjigjet e subjektit ndaj rezultateve të hetimit për aftësitë profesionale, po ashtu adresohen disa çështje ligjore, të cilat nuk janë sqaruar plotësisht nga arsyetimi i Komisionit, si:

- Në lidhje me konstatimin se subjekti ka dështuar në përgjithësi në respektimin e afateve ligjore të gjykimit, siç parashikohet në ligjin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, pas sqarimeve dhe dëgjimit të subjektit¹², Komisioni ka konkluduar se ai ka shpjeguar bindshëm këtë gjetje. ONM-ja vlerëson se afati 30-ditor është standard që KLD-ja¹³ aplikon për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve, bazuar në aneksin 1 të vendimit të saj nr. 261/1 i vitit 2010, pra në këtë rast nuk mund t’i adresohemi K. Pr. Civile apo ligjit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, por ligjit për statusin dhe vendimit respektiv të KLD-së.

- Komisioni ka konstatuar se dosjet gjyqësore të analizuara kanë qenë jo të plota dhe me mangësi, pasi subjekti nuk ka ndërmarrë vendime të ndërmjetme apo urdhra gjyqësorë. Në disa raste janë konstatuar gjithashtu mungesa e procesverbaleve gjyqësore dhe parregullsi të veprimeve përgatitore, si thirrja e palëve etj. Por pas shpjegimeve të subjektit, Komisioni ka vlerësuar se në përgjithësi aktet përgatitore janë kryer në mënyrë të rregullt dhe palët janë thirrur rregullisht me mjete të tjera të parashikuara me ligj, edhe pse nuk janë nxjerrë akte të veçanta procedurale me shkrim. Në lidhje me mungesën procesverbaleve, Komisioni ka mbajtur qëndrimin se kjo nuk është përgjegjësi e subjektit, por e sekretarisë gjyqësore. Sipas ONM-së, mbetet për t’u parë nëse kjo qasje vjen në përputhje me nenin 25 dhe 27 të ligjit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ky ligj nuk parashikon se procesverbalet gjyqësore janë zëvendësuese e veprimtarisë gjyqësore, në mënyrë që t’i konsiderojmë vendimet dhe urdhrat gjyqësore si të panevojshme.

- Komisioni gjeti se, në disa raste, subjekti ka referuar gabimisht bazën ligjore të aplikueshme. Subjektit në lidhje me këtë, referon vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 3/2012, që gjyqtarët (në zgjidhjen e çështjes) nuk lidhen apo janë të detyruar nga baza ligjore e padisë. ONM-ja vëren se subjekti ka sqaruar mospërputhjen midis bazës ligjore të një padie dhe bazës ligjore të vendimit, duke iu referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, ndërsa gjetja e Komisionit ka identifikuar mospërputhje në pjesën hyrëse të vendimit gjyqësor (jo të padisë)

¹¹ ONM-ja vlerëson se bazuar në vendimin nr. 262/2 i vitit 2010, të KLD-së, shqyrtimi i 150 rasteve në vit nuk është standardi, por minimumi i ngarkesës në punë.

¹² Sipas subjektit, afati 30-ditor, specifikuar në nenin 327 të K.Pr. Civile është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar.

¹³ Nën cilësinë e organit kompetent për rivlerësimin kalimtar të aftësive profesionale, sipas nenit 179/5 të Kushtetutës dhe nenit 160, pika 1, germa “dh”, dhe neni 173, pika 1, germa “a” e ligjit për statusin.

me pjesën arsyetuese të vendimit. Prandaj pjesa e arsyetimit dhe baza ligjore e referuar në të njëjtin vendim nuk përputhen.

8.1.1.ç Vlerësimi profesional në përgjithësi. Në mënyrë të përmbledhur, referuar pikës 3, prg. 3 të rekomandimit, rezulton se trupi gjykues i Komisionit bazuar në nenin B, pika 3, germa “b¹⁴” e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 11,¹⁵ e ligjit nr. 84/2016, për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka marrë në konsideratë mendimin/opinionin e ONM-së (bashkëngjitur rekomandimit) që paraqet “metodologjinë” e vlerësimit profesional. Trupi gjykues ka përdorur gjithashtu “tabelën vlerësuese” si një mjet për vlerësimin profesional në mënyrë objektive. Sipas këtij rekomandimi (pika 4/4, nënpika 3), trupi gjykues në shumicë, ka zgjedhur në këtë rast qasjen I. Por ngrihet shqetësimi se kjo qasje vetëm për raste të qarta mund të nxjerrë rezultat të kundërt nga vlerësimi “i aftë”, kjo pasi mungojnë standardet objektive, standardet e aplikueshme dhe të dhënat mbi performancën e magistratëve në përgjithësi. Në këndvështrimin e ONM-së, kjo qasje është mjaft e butë, fakt i cili, nëse adoptohet në përgjithësi mund të nënkuptojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për aftësitë profesionale nuk do të kontribuojë ndjeshëm në përmirësimin e aftësive profesionale të gjyqësorit në Shqipëri. Si rrjedhojë e kësaj, procesi i verifikimit rrezikon të mos përmbushë qëllimet e parashikuara në Kushtetutë, nëse kjo qasje do të përdoret si “metodologji” standarde e vlerësimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit.

8.2 Rekomandimi: sfida për Kolegjin e Apelimit. Sipas vlerësimit të ONM-së, apelimi i vendimit do të mundësojë që Kolegji i Apelimit të:

- vendosë nëse rezultati i vlerësimit të aftësisë profesionale në rastin konkret është i justifikuar;
- sqarojë disa çështje ligjore dhe,
- e fundit, por jo më pak e rëndësishmja, ofrojë disa udhëzime të përgjithshme mbi qasjen dhe metodologjinë e vlerësimit të aftësive profesionale.

8.3 Në datë 13.9.2018, i njëjti komision, i përbërë nga 3 përfaqësues të ONM-së, depozituan pranë Komisionerit Publik një addendum të “Rekomandimit për paraqitje ankimi”, dorëzuar në datë 9.8.2018.

8.3.1 Në këtë akt, komisioni i 3 përfaqësuesve të ONM-së ka paraqitur pranë Komisionerit Publik të gjitha gjetjet në lidhje me mangësitë profesionale të subjektit, duke i analizuar në secilën prej 13 çështjeve të marra në shqyrtim gjatë procesit të rivlerësimit të zhvilluar nga ana e Komisionit.

IV. Shkaqet e ankimit

9. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisionerët Publikë është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit (Vetting).

10. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të

¹⁴ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelimit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelimit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose persona privatë, sipas ligjit.

¹⁵ Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar konsiderohet një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta. Mendimi mund të ndikojë në vendimmarrjen e Komisionit ose Kolegjit të Apelimit, por nuk ka vlerën e provës.

Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese (në vijim referuar si Kolegji).

11. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga dispozitat e nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, neneve 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.

12. Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin në detyrë ose shkarkimin e magjistratit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt.

13. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik gjatë shqyrtimit të vendimit nr. 60, datë 31.8.2018 të Komisionit, e ka kryer këtë kontroll bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore.

13.1. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj, Komisioneri Publik konstaton se për sa i takon i) kriterit të vlerësimit të pasurisë; dhe ii) kriterit të kontrollit të figurës, vendimi nr. 60, datë 1.8.2018, i Komisionit, bazohet në provat dhe faktet që janë administruar gjatë hetimit administrativ.

13.2. Ndërkohë, në lidhje me iii) kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, kreut VII të ligjit nr. 84/2016 dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, në vlerësimin e Komisionit Publik, vendimi i është i cenueshëm.

14. Gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale për subjektet që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin dhe hetimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht ligji nr. 96/2016.

15. Kreu VI i ligjit nr. 84/2016 ka përcaktuar rregullat e përgjithshme, burimet dhe procedurën që ndiqet për të hetuar dhe vlerësuar aftësitë profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Aftësitë profesionale të subjekteve të rivlerësimit kanë qenë dhe vijnë të jenë objekt i vlerësimit dhe nga organet e tjera qeverisëse të sistemit të drejtësisë, që kanë pjesë të kompetencës së tyre kushtetuese, garantimin e standardeve më të larta të profesionalizmit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

16. Thënë kjo, Komisioneri Publik gjen me vend të nënvizojë se procedurat e vlerësimit të aftësive profesionale, për efekt të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 dhe procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si i tërë, nuk mund të konsiderohet thjesht në nivelin konstatues dhe certifikues të gjetjeve të organeve të tjera ndihmëse, që mbështesin institucionet e rivlerësimit, sikundër janë Inspektorati apo struktura e posaçme pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

17. Në lidhje me kompetencat, rolin e patjetërsueshëm, unik, udhëheqës dhe origjinar që kanë

institucionet e rivlerësimit gjatë kryerjes së këtij procesi të posaçëm, në kontrollin e kriterëve të parashikuara në Kushtetutës, mes të cilave dhe atij të aftësive profesionale, sjellim në vëmendje qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila pasi kërkoi dhe mori dhe një *amicus curiae* nga Komisioni i Venecias në lidhje me pajtueshmërinë e legjislacionit të procesit të rivlerësimit kalimtar me GjEDNj, arsyeton se: “22. *I gjithë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, edhe pse është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, duke parashikuar institucionet që do të kryejnë këtë proces, kompetencat e tyre, si edhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe garancitë që ata gëzojnë. Qëllimi i përcaktimit të kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato”.*

18. Në këtë interpretim të normave kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese, nën udhëzimet e *amicus curiae* të Komisionit të Venecias, duke marrë në konsideratë mundësinë e mbivendosjes ose marrjen *de facto* të kompetencave rivlerësuese nga institucione të tjera, ekzistuese, të ndryshme nga ato të rivlerësimit është shprehur se: “32. *Gjykata vlerëson se këto organe nuk e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ligjore në mënyrë të shkëputur nga veprimtaria e organeve të rivlerësimit, KPK-ja dhe KPA-ja, por nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e këtyre të fundit. Për shkak të misionit që ato kanë dhe funksionit që kryejnë, qëllimi i përfshirjes së tyre në këtë proces është që të ndihmojnë organet kushtetuese në ushtrimin e kompetencave kushtetuese. Duke bërë një interpretim të tillë të këtyre dispozitave ligjore konkludohet se edhe në këtë rast ligji nuk e ka zhvendosur kontrollin dhe hetimin tek organet ekzistuese dhe ato nuk kanë marrë dhe as nuk ushtrojnë kompetencat që u njihen organeve të reja kushtetuese”.*

19. Është e rëndësishme të theksohet se institucionet e rivlerësimit, posaçërisht, Komisioni, në referencë të rolit që i njihet nën 179/b, pika 5, i Kushtetutës në këtë proces, duhet të sigurojnë të gjithë mjetet dhe mënyrat e përshtatshme, brenda parashikimeve ligjore, që bëjnë të mundur që të tria kriteret e rivlerësimit kalimtar, i) pasuria; ii) figura; iii) profesionalizmi, të vlerësohen mbi bazën e një metodologjie transparente, origjinare dhe të përshtatshme, me qëllim arritjen e objektivit kryesor të procesit, rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

20. Në vlerësimin e Komisionerit Publik është detyrë e të gjitha institucioneve të rivlerësimit, që ky proces, duke u udhëhequr nga transparencja dhe profesionalizmi, të mund të realizohet duke qenë institucionet e rivlerësimit të përgatitur për të përmbushur ata vetë kompetencat e tyre ligjore, sigurisht në frymën e bashkëpunimit me institucionet e tjera ekzistuese, por pa krijuar varësi nga metodologjia dhe rezultatet e ushtrimit të kompetencave nga këto organe, të cilat sipas parashikimit kushtetues, luajnë vetëm një rol ndihmës në këtë proces.

21. Në jurisprudencën e lartpërmendur kushtetuese, thuhet qartë se: “40. *Në përfundim, Gjykata vlerëson se dispozitat e ligjit garantojnë aksesin në të gjithë informacionin dhe dokumentet e disponuara nga grupi i punës, dhe garantojnë kontrollin efektiv mbi veprimtarinë e grupeve të punës nga KPK-ja. Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (KPK-ja dhe KPA-ja) të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme”.*

22. Megjithëse, roli i institucioneve të tjera të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj, gjatë

procesit të rivlerësimit, është i dorës së parë, Kushtetuta dhe ligji i detyron institucionet e rivlerësimit që të ushtrjnë të pavarur kompetencën e tyre dhe të marrin përgjegjësitë për të gjetur mjetet procedurale efektive për këtë qëllim. Kjo është dhe fryma e interpretimit kushtetues në të njëjtin vendimin, teksa arsyetohet: *“44. Gjykata, duke bërë një interpretim sistematik të dispozitave të ligjit të kundërshtuar, nga konteksti i tyre, si dhe nisur nga kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, vlerëson se qëllimi i tyre është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen gjatë procesit të rivlerësimit nga organet kushtetuese të pavarura, të cilat janë të vetmet organe që kanë kompetencën për të realizuar kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, si dhe kriteret dhe mënyra e realizimit të këtij procesi. Në këtë kuptim, e gjithë fryma që përshkon dispozitat kushtetuese dhe që reflektohet edhe në dispozitat konkrete të ligjit të kundërshtuar është se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve kryhet nga organet e rivlerësimit me ndihmën e organeve të tjera shtetërore ekzistuese, të cilat për shkak të qëllimit për të cilin janë krijuar, mënyrës së organizimit dhe funksionimit, si dhe kompetencave që ushtrjnë do të ndihmojnë organet e rivlerësimit në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe përmbushjen e misionit të tyre”.*

23. Si pjesë e këtij interpretimi, nisur nga specifikat që secili nga kriteret e rivlerësimit mbart në vetvete, Komisioneri Publik çmon se veçanërisht për të garantuar efikasitetin e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, në mënyrë profesionale dhe transparente, brenda kufijve të vendosur me ligj, është e domosdoshme që institucionet e rivlerësimit të përdorin një metodologji të qartë, e cila përfshin dhe bën pjesë të saj edhe vlerësimin e Inspektoratit, por nuk mbetet e varur prej tij.

24. Vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale, në vlerësimin e Komisionerit Publik ka një rëndësi thelbësore dhe nuk mund të konsiderohet si një element më pak i rëndësishëm sesa vlerësimi i pasurisë apo kontrollit të figurës në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

25. Ndërkohë, Komisioneri Publik konstaton se, në vendimin konkret të Komisionit, kriteri i vlerësimit të aftësive profesionale rezulton të jetë analizuar si një element, ekzistenca e të cilit është e varur nga ekzistenca e gjetjeve në vlerësimin e pasurisë dhe atë të kontrollit të figurës, pasi vetëm kështu, duke ndikuar në pasurim të padrejtë ose cenim të figurës së subjektit të rivlerësimit, mungesa e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit mund të cenojë besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

26. Kjo qasje, në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk është shprehje e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Vlerësimi i aftësive profesionale, vlerësimi i pasurisë dhe vlerësimi i kontrollit të figurës, po aq sa janë të ndërlidhur, qëndrojnë të pavarur gjatë kryerjes së procedurave dhe arritjen e përfundimeve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Secili nga këto kritere është po aq i rëndësishëm dhe vendimtar për konfirmimin ose jo të subjekteve të rivlerësimit.

27. Interpretime të kundërta mesa më lart, mund të na udhëheqin në situata të tilla, kur një subjekt rivlerësimi arrin të konfirmohet, vetëm sepse kalon nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë dhe kontrollit të figurës, paçka se çalon në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

28. Një gjyqtar apo prokuror i papërshtatshëm profesionalisht, dëmton po aq besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë, se sa një subjekt i rivlerësimit, që rezulton me pasuri të pajustificuara ose kontakte apo sjellje te papërshtatshme.

29. Interpretimi i mësipërm, gjen materializim dhe në çështjen konkrete të shqyrtuar nga Komisioni, për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Medja. Komisioni me të drejtë konstaton se subjekti i rivlerësimit kalon nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë dhe të kontrollit të figurës, por në vlerësimin e Komisionerit Publik, Komisioni nuk ka arritur të evidentojë, kategorizojë dhe të vlerësojë siç duhet një sërë gjetjesh, që lidhen me mangësi të konsiderueshme të aftësive profesionale të shfaqura nga z. Gentian Medja.

IV. A Vlerësimi i aftësive profesionale

IV.A.1 Procedura dhe vlerësimi i Inspektoratit

30. Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016, vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit ka për qëllim identifikimin e atyre që nuk kanë kualifikimin e duhur profesional për të ushtruar detyrën dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.

31. Në lidhje me kriteret dhe procedurën e vlerësimit të aftësive profesionale, kreu IV, i ligjit nr. 84/2016 referon tek përmbajtja e dispozitave përkatëse të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kriteret e vlerësimit të magjistratit, gjyqtar e prokuror, ligjvënësi i ka parashikuar në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

31.1. Kriteret e vlerësimit materializohen në:

- i) aftësinë profesionale;
- ii) aftësinë organizative;
- iii) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- iv) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

31.1.2. Këto kriteret vlerësuese, në harmoni me parashikimin e nenit 41/3 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohen në tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës së subjektit dhe sipas shtojcës 4 të ligjit, bazohet në 3 dokumente ligjore të përzgjedhura prej subjektit dhe 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv e rastësor.

A.1.1 Raportet i Inspektoratit

32. Edhe në rastin konkret, organi ndihmës/mbështetës i vlerësimit të aftësive profesionale, Inspektorati, bazuar në nenin 44/2 të ligjit nr. 84/2016 ka përgatitur dhe përcjellë fillimisht raportin¹⁶ e parë (3+5) dhe me kërkesë të Komisionit, në vijim ka përcjellë edhe raportin¹⁷ e dytë, për 5 dosje gjyqësore shtesë.

32.1. Referuar raportit të parë, konstatohet se Inspektorati ka adresuar mangësi vetëm për kriterin e aftësive organizative të subjektit (*aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë, për*

¹⁶ Shkresa nr.***, datë ***.2.2018 e Inspektoratit. Analiza e gjetjeve të raportit I i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti (ii) 5 dosje të vëzhguara të përzgjedhura me short dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së. Në lidhje me burimet arkivore, rezultoi se për subjektin janë paraqitur 8 ankesa, ku 4 prej tyre janë arkivuar pas shqyrtimit, 3 të tjera kanë rezultuar të pabazuara pas verifikimit, ndërsa 1 ankesë e vitit 2016 është regjistruar për vlerësimin profesional dhe etik për shkak të tejkalimit të afatit standard të gjykimit.

¹⁷ Protokolluar pranë Komisionit me nr.*** datë ***.4.2018.

të kryer procedura gjyqësore dhe administruar dosjet), duke nxjerrë në pah tejkalimin e standardit për gjykimin e çështjeve brenda 1 muaji.

32.2. Në këtë raport, Inspektorati e justifikon këtë të dhënë, me planifikimin e seancave dhe lejen vjetore të gjyqtarëve, e kombinuar me ngarkesën e lartë sasiore të subjektit.

32.3. Ndërsa për 3 dokumentet ligjore (vendime) të dorëzuara nga vetë subjekti, Inspektorati konstaton se në 2 prej tyre, të dhënat mbi respektimin e afatit të gjykimit, nuk mund të vlerësohen sepse nuk janë shënuar në vendim. Në një rast tjetër, gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 6 ditë, duke tejkaluar afatin standard të gjykimit prej 1 muaji. Në lidhje me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga 5 dosje, në 3 raste vendimi është arsyetuar përtej afatit 7-ditor.

32.4. Në rastin e tri vendimeve të paraqitura nga subjekti, rezulton se vetë Inspektorati nuk ka shqyrtuar fizikisht dosjet gjyqësore të këtyre vendimeve, duke argumentuar pamundësinë e vlerësimit të plotë të 2 prej këtyre vendimeve pikërisht me mosadministrimin e dosjeve gjyqësore.

33. Inspektorati hartoi një raport të dytë, mbi kërkesën e Komisionit, për 5 dosjet gjyqësore të prazgjedhura për herë të dytë. Edhe në 5 dosjet shtesë të marra për vlerësim, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në kryerjen e detyrës së tij shfaqte në mënyrë të përsëritur në njëjtat mangësi. Por, n.q.s. disa prej këtyre mangësive, konstatoheshin dhe vlerësoheshin si të tilla nga Inspektorati në raportin e parë që iu përcoll Komisionit, nuk rezulton që këto mangësi të jenë trajtuar si të tilla dhe në raportin e dytë.

33.1. Kështu, është për t'u shënuar që në këtë raport të dytë të hartuar nga Inspektorati, ndryshe nga sa vlerësonte raporti i parë i hartuar po nga ky Inspektorat, nuk konstatohet si mangësi tejkalimi i afatit 1 mujor për përfundimin e gjykimit. Në këtë përfundim, Inspektorati ka arritur, duke bërë pjesë të raportit të tij, të njëjtin argument ligjor të përdorur nga subjekti në përgjigjet e dhëna për Komisionit, duke referuar te mungesa e bazës ligjore për përcaktimin e këtij afati.

33.2. Në raportin e tij të dytë, Inspektorati vlerëson se ligji nr. 49/2012 nuk parashikon afat për përfundimin e gjykimit administrativ, përveç afatit 7-ditor për vënien në lëvizje të çështjes, afat që është respektuar nga subjekti, sipas Inspektoratit.

33.3. Inspektorati ka arsyetuar se Aneksi 1 i Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve (vendimi i KLD-së nr. 261/2, datë.14.4.2010), është miratuar përpara hyrjes në fuqi të legjislacionit që parashikon ngritjen e sistemit të gjykatave administrative. Ky sistem vlerësimi, që parashikon në pikën 5 germa "c" të aneksit, afatin 1-mujor për përfundimin e gjykimit të çështjeve administrative nga regjistrimi në gjykatë, sipas Inspektoratit, nuk mund të përdoret për sa kohë është miratuar në kohë, më përpara, hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012.

33.4. Bazuar mbi këtë argument, të ndryshëm nga ai që përdoret në raportin e parë për të njëjtin subjekt rivlerësimi, në raportin e dytë, Inspektorati, pasi analizon natyrën procedurale dhe afatet përkatëse të gjykimit administrativ (veprimet përgatitore, njoftimi i palëve dhe kalimi në seancë gjyqësore), të cilat e tejkalojnë afatin 1 mujor, shprehet se subjekti i ka gjykuar çështjet në respektim të standardit "gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm", arsyetim ky i përdorur për të 5 dosjet shtesë, për të cilat i është kërkuar vlerësim nga Komisioni.

A.1.2 Mangësitë e konstatuara në aktet (burimet) e përdorura për rivlerësimin profesional

- 5 dosjet e përzgjedhura nga shorti i parë

i) Dosja 1 (***) vs (***)). Nga analizimi i dokumenteve të dosjes gjyqësore, rezulton se subjekti nuk ka respektuar afatin 7-ditor për veprimet përgatitore, referuar nenit 25/1 të ligjit nr. 49/2012; nuk gjenden urdhra apo vendime të ndërmjetme, referuar nenit 25/2 të ligjit nr. 49/2012, si dhe nuk është respektuar afatin 15-ditor për caktimin e seancës, referuar nenit 27 të ligjit nr. 49/2012. Vendimi gjyqësor nuk përmban pretendimet përfundimtare të palëve, kërkesë kjo e nenit 41, të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 310, prg.1, pika 7 e K. Pr. Civile. Pjesa arsyetuese dhe baza ligjore të cilës i referohet, nuk përputhen midis tyre, pasi baza ligjore përfshin një rreth të zgjeruar dispozitash ligjore. Për sa i përket bazës ligjore në aktin për njoftimin e palëve, nuk bëhet referencë në ligjin për gjykatat administrative. Subjekti i referohet Kodit të Procedurës Civile, duke anashkaluar *lex specialis* që rregullon veprimtarinë e tij si gjyqtar pranë gjykatës administrative. Referenca në ligjin për gjykatat administrative mungon edhe në vendimin përfundimtar të gjykatës. Vendimi është marrë përtej afatit 30-ditor, i përcaktuar në aneksin 1 të vendimit të KLD-së, nr. 261/1, viti 2010.

ii) Dosja 2, (***) vs (***)). Çështja është pushuar me kërkesë të paditësit, megjithatë siç raporton Inspektorati, subjekti e ka dorëzuar dosjen në sekretari gjyqësore pas 15 ditësh, përtej afatit të parashikuar në nenin 64, të ligjit nr. 49/2012.

iii) Dosja 3, (***) vs (***)). Nga analizimi i dokumenteve të dosjes gjyqësore, rezulton se subjekti nuk ka lëshuar asnjë vendim të ndërmjetëm apo urdhër; mungojnë veprimet për thirrjen e seancës përgatitore dhe aktet e ndryshme përgatitore parashikojnë vendime dhe njoftime që kundërshtojnë njëra-tjetrën; baza ligjore e cituar në vendimin e formës së prerë, i referohet ndër të tjera, nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton rastet kur ngrihet padia, kur kjo referencë duhet dhe mund të bëhet tek ligji i posaçëm nr. 49/2012, neni 17 i ligjit. Në këtë rast subjekti ka bërë referencë të gabuar ligjore.

iv) Dosja 4, (***) vs (***)). Nuk është zbatuar afati 15-ditor për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, sipas nenit 27/1, të ligjit nr. 49/2012; nuk janë lëshuar vendime të ndërmjetme apo urdhra, përfshirë edhe njoftimin e palëve. Subjekti duhet të kishte marrë masat e parashikuara nga ligji për mënyrën e njoftimit të palëve që nuk kanë qenë prezent, konkretisht Avokaturës së Shtetit.

v) Dosja 5, (***) vs (***)). Në dosje nuk përfshihet procesverbali apo informacion lidhur me aktet përgatitore, vendime apo urdhra. Subjekti nuk ka respektuar afatin ligjor, përcaktuar në nenin 25/1-27/1 të ligjit nr. 49/2012, në lidhje me aktet përgatitore të seancës gjyqësore. Subjekti ka bërë referencë të gabuar ligjore, pasi i referohet nenit 179 të ligjit nr. 49/2012 (dispozitë që nuk ekziston), ndërkohë kjo dispozitë i përket K. Pr. Civile. Në vendimin përfundimtar nuk bëhet referencë mbi ligjin nr. 49/2012. Subjekti referon si bazë ligjore të aplikueshme vetëm Kodin e Punës.

- 3 vendimet e përzgjedhura nga subjekti:

i) Vendimi 1 (***) vs (***)). Shqyrtimi i çështjes dhe dhënia e vendimit ka qenë tej një afati të arsyeshëm kohor, mbi 1 vit. Në vendim, subjekti nuk i referohet si bazë ligjore, *lex specialis*, ligjit nr. 49/2012. Gjykata/subjekti, është shprehur ndër të tjera në dispozitiv se *..Vendimi mund të ankimohet në gjykatën administrative të apelit brenda 5 ditëve...* Ndërkohë

që afati 5-ditor i ankimit është afat kohor i parashikuar në K. Pr. Civile, në rastin e ankimeve të veçanta. Ligji nr. 49/2012 i referohet afatit 5-ditor, vetëm në disa raste specifike¹⁸.

ii) *Vendimi 2* (***.*** vs ***). Mungojnë aktet procedurale, si urdhra dhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës, procesverbali i mbajtur nga sekretaria gjyqësore etj. Nga vendimi gjyqësor konstatohet se paditësit kanë kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ ndërsa gjykata ka vendosur “shfuqizimin e procedurës”. Gjykata megjithëse ka pranuar padinë, në dispozitiv shprehet me terminologji ndryshe, e cila nuk i përshtatet natyrës së vendimmarrjes, referuar nenit 40 të ligjit nr. 49/2012.

iii) *Vendimi 3* (*** *** *** vs ***). Konstatohet e njëjta problematikë, mungojnë aktet procedurale, si urdhra dhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës, procesverbali i mbajtur nga sekretaria gjyqësore etj.

- 5 dosjet e përzgjedhura nga shorti i dytë

i) *Dosja 1* (***.*** etj. vs ***). Gjykimi i çështjes ka zgjatur 4 muaj e 16 ditë, i zhvilluar në 6 seanca gjyqësore. Në përfundim gjykata (subjekti i rivlerësimit) ka rrëzuar padinë me argumentimin se paditësve i mungon legjitimiteti aktiv. Në lidhje me rregullsinë dhe përmbajtjen e njoftimeve të palëve në gjykim, konstatohet se njoftimi dhe pse është lëshuar për thirrjen e seancës përgatitore, përmban dispozita lidhur me seancën gjyqësore/dëgjimore, njoftime këto me natyrë qartësisht procedurale të ndara në ligjin për gjykatat administrative. Për më tepër, gjykata nuk rezulton të ketë njoftuar palët për depozitimin e provave, dëshmimeve, ose dëshmitarëve, siç parashikohet në nenin 25 prg. 1, shkronja b e ligjit 49/2012. Të njëjtat të meta konstatohen dhe në njoftimet ndaj paditësve të tjerë, përkatësisht ***. ***, ***, ***, ***, ***. Në dosje nuk gjenden gjithashtu vendime të ndërmjetme të gjykatës. Konstatohet se më datë ***.6.2014 është mbajtur seanca përgatitore dhe sipas procesverbalit të seancës palët e pranishme kanë kërkuar rishikimin e bazës ligjore të padisë, pasi ka hyrë në fuqi ligji nr. 49/2012 dhe padia e parë e depozituar në gjykatën civile është hartuar me bazë të ndryshme ligjore. Sipas nenit 25 të ligjit nr. 49/2012, është gjykata ajo, e cila gjatë veprimeve përgatitore, i kërkon paditësit të plotësojë të metat e padisë, konkretisht bazën ligjore, brenda një afati 10-ditor, fakt që në këtë rast nuk është konstatuar nga subjekti por është pranuar prej tij vetëm pas kërkesës së vetë palës gjyqësore. Në lidhje me gjykimin e çështjes dhe rrëzimin e padisë për shkak mos legjitimiteti të palëve mbas 4 muajve, subjekti duhet ta vlerësonte këtë fakt, jo në vendimin përfundimtar, por në fazën paraprake. Sipas nenit 25 të ligjit nr. 49/2012, kjo çështje duhej trajtuar nga gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë. Gjykata kur konstaton mangësi i kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Po ashtu sipas nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile... “Gjykata verifikon legjitimitetin si palë të personave ose të përfaqësuesve të tyre të paraqitur dhe kur është rasti i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe, kur e sheh të nevojshme, u cakton palëve një afat.” Subjekti, në këtë rast nuk ka siguruar një gjykim të efektshëm dhe në përputhje me ligjin.

ii) *Dosja 2* (***.*** vs ***). Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 muaj e 27 ditë, zhvilluar në dy seanca gjyqësore, ku në përfundim gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Në njoftimin e seancës përgatitore të datës ***.12.2015, gjykata i referohet gabim nenit 6 të Kodit

¹⁸ Ligji për gjykatat administrative parashikon ankim të veçantë vetëm në rastet e mëposhtme: neni 9, Kundërshtimi i juridiksionit; neni 32, Rasti i refuzimit të padisë, masë sigurimi; neni 46, Për kthimin e kërkesë padisë; neni 57 për kthimin e rekursit.

të Procedurës Administrative, aplikimi i të cilit nuk lidhet me rastin objekt shqyrtimi. Gjykata/subjekti gjithashtu i referohet nenit 153 të K. Procedurës Civile, ndërkohë mund ti referohej ligjit specifik që kishte hyrë në fuqi, ligjit nr. 49/2012, nenit 17 të tij¹⁹. Referencat e gabuara ligjore gjenden në të gjitha njoftimet, shënimet dhe madje edhe në vendimin përfundimtar. Nuk rezultojnë të jenë lëshuar vendime të ndërmjetme apo urdhra të gjykatës në këtë rast.

iii) Dosja 3 (***.*** vs *** ***)). Gjykimi i çështjes ka zgjatur 2 muaj e 5 ditë, ku shkak i kohëzgjatjes së gjykimit ka qenë dështimi i shërbimit postar për njoftimin e paditësit për plotësimin e të metave të padisë. Dosja nuk përmban kopje të njoftimeve për palën.

iv) Dosja 4 (***.*** vs *** ***)). Gjykimi i çështjes ka zgjatur 4 muaj e 12 ditë, ku përfshihet edhe leja vjetore e subjektit. Konstatohen të njëjta problematika dhe referim i gabuar i bazës ligjore në lidhje me njoftimin e palëve.

v) Dosja 5 (***.*** vs *** ***)). Gjykimi i çështjes ka zgjatur 3 muaj e 3 ditë, zhvilluar në 5 seanca gjyqësore, ku ka pasur vetëm një seancë jo produktive si shkak i njoftimeve nga shërbimi postar.

34. Për këto mangësi profesionale të konstatuara, që janë shfaqur sistematike gati në të gjitha dosjet e përzgjedhura, si nga subjekti i rivlerësimit, ashtu dhe ato të shortuara, fillimisht nga ana e Komisionit i është kaluar subjektit të rivlerësimit barra e provës.

35. Pas administrimit të prapësimeve të subjektit dhe administrimit të raportit të dytë të Inspektoratit, shumica e Komisionit duket se i ka gjetur të argumentuara pretendimet e subjektit pasi arsyeton se:

- në lidhje me mosrespektimin e afateve të gjykimi nga ana e subjektit, subjekti ka detyrimin për të vepruar sipas ligjit nr. 49/2012, i cili ka parashikuar një afat të arsyeshëm për gjykimin e çështjeve, pa përcaktuar një afat kohor, duke mos marrë në konsideratë kështu afatin 1 muaj, përdorur në vlerësimin e Inspektoratit, sipas vendimi nr. 262/1, i datë 14.4.2010, të KLD-së;
- në lidhje me parregullsitë për veprimet përgatitore, nga procesverbalet e dorëzuara nga subjekti, konstatohet se përgjithësisht procedurat janë kryer rregullisht dhe palët janë njoftuar gjatë seancave gjyqësore (kur kanë qenë prezent) ose në mënyra të tjera që ligji i lejon, edhe pse nuk ka pasur akte shkresore të posaçme. Neni 148 i K.Pr.A. parashikon se njoftimi i palëve për seancë, mund të bëhet verbalisht kur pala është e pranishme, ose në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme të njoftimit, sipas përcaktimeve në dispozitat ligjore të këtij ligji;
- në lidhje me mungesën e urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, kërkesë e neneve 25 dhe 27 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, subjekti ka argumentuar duke vërtetuar me procesverbalet e seancave gjyqësore, se të gjitha veprimet e kryera prej tij, urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme gjatë seancave përgatitore dhe gjyqësore, edhe pse nuk janë pasqyruar në akte më vete, janë të dokumentuara në procesverbalet e seancave gjyqësore (ashtu sikurse neni 25 i ligjit nr. 49/2012 e lejon), duke i justifikuar mangësitë me ngarkesën e lartë në punën e tij dhe të sekretarisë gjyqësore. Për të vërtetuar ngarkesën, subjekti ka paraqitur edhe kalendarin e çështjeve gjyqësore, nga të cilat ka rezultuar se ai ka punuar 12-16 orë në ditë, zhvillimi i 10, 12-18 seanca në ditë si dhe larminë dhe kompleksitetin e çështjeve;
- në lidhje me konstatimin mbi referencat e gabuara ligjore, subjekti e ka pranuar dhe si shkak ka referuar ngarkesën në punë të tij por dhe të sekretarisë gjyqësore. Ndërsa në rastin e

¹⁹ Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mos marrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

konstatuar se është zbatuar referencë ligjore e ndryshme nga ajo e kërkesëpadisë, subjekti ka argumentuar duke u bazuar në Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.3/2012.

- Referuar parashikimeve të neneve 75-76 të ligjit nr. 96/2016, nuk kanë rezultuar të dhëna apo gjetje negative nga regjistri i ankesave dhe procedimeve disiplinore. Gjithashtu nuk kanë rezultuar të dhëna negative lidhur me trajtimin e çështjeve.

36. Sikundër u parashtrua edhe më lart në këtë ankim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzionet e arritura nga Komisioni mbi mangësitë e konstatuar në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja, nuk janë të mbështetura në një metodologji të qartë.

36.1. Qasja dhe arsyetimi i përdorur në rastin konkret nga ana e Komisionit, është një vlerësim i përgjithshëm, që i bëhet kriterëve të parashikuara nga neni 71, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

36.2. Ky vlerësim i përgjithshëm, edhe pse në pamje të parë duket se bën referencë tek disa indikatorë objektive të vlerësimit të kriterëve profesionale, nuk pasqyron në mënyrë konkrete, rast pas rasti, anët pozitive dhe negative që shfaq veprimtaria e subjektit të rivlerësimit.

36.3. Kjo qasje e përzgjedhur nga Komisioni, pasqyron vetëm bën një shumatore të mangësive të konstatuara në aftësitë profesionale të subjektit, pa dhënë mundësinë për të vlerësuar në detaje se sa kanë ndikuar këto mangësi në dhënien e drejtësisë për çdo dhe secilin subjekt të posaçëm, që i është drejtuar gjykatës për të marrë drejtësinë që ai pretendon se i mohohet.

36.4. Kjo mënyrë vlerësimi e zgjedhur nga Komisioni, për të arritur në përfundime në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, duke iu referuar një vlerësimi të përgjithshëm, në këndvështrimin e Komisionerit Publik do të mund të sillte konstatime të sigurta vetëm në ato raste, kur çështjet e shqyrtuara kanë prani të theksuar të mangësive profesionale, të tilla që e bëjnë të dukshëm vlerësimin si “të papërshtatshëm” të subjektit të rivlerësimit.

36.5. Në shumicën e rasteve, kjo qasje do të bënte të pamundur evidentimin e rasteve ku “papërshtatshmëria” ose “mangësitë” e subjektit të rivlerësimit do të vinin si rezultat i një vlerësimi mbi indikatorë objektive, të matur çështje pas çështje, e duke u dhënë peshën e nevojshme për rivlerësimin e aftësive profesionale, kur ato përsëriten dhe janë sistematikë në veprimtarinë profesionale të subjekteve të rivlerësimi.

36.6. Në vlerësim të Komisionerit Publik, në rastin konkret, metodologjia e vlerësimit e përzgjedhur nga ana e Komisionit nuk mund të jetë e mjaftueshme për të arritur në një përfundim objektiv në evidentimin e mangësive të subjektit në aspektin e aftësive profesionale.

36.7. Në vijim të këtij vlerësimi, në lidhje me ngarkesën e punës, Komisioni, pjesë të metodologjisë së tij të vlerësimi, duke iu referuar kriterëve të parashikuara në nenin 71 të ligjit nr.96/2016 e të zbërthyer në indikatorë objektivë, të tillë siç parashikojnë nenet 72-74-75-6 të të njëjtit ligj, duhet të konsideronte të gjitha aspektet që përbëjnë një performancë të mirë gjyqësore.

36.7.1. Për shembull, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore matet me treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për organizimin e procesit gjyqësor, mënjanimin e seancave gjyqësore joproductive, duke përfshirë edhe monitorimin e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit të palëve.

Burime të tjera të vlerësimit, veçanërisht në lidhje me aftësitë organizative, janë aftësia për të mbajtur me rregullsi aktet në dosjen gjyqësore si dhe krijimin e tyre pa mungesa.

36.8. Lidhur me arsyetimin e Komisionit se “...subjekti ka rrëzuar disa nga parregullsitë procedurale të konstatuara dhe se mangësitë ekzistente nuk vërtetojnë që subjekti ka njohuri, aftësi në gjykim dhe qëndrime ose modele pune aq të dobëta...”, vlerësojmë se, fakti se në të 13 çështjet janë konstatuar mangësi, si, mosrespektim i afateve të gjykimit, mangësi në veprimet përgatitore procedurale, njoftimin e palëve si dhe referencë të gabuara ligjore, janë të mjaftueshme që të tregojnë se këto mangësi janë “model” sistematik dhe jo rastësor.

36.9. Mosrespektimi i afateve dhe mangësitë procedurale në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e procesit është përgjegjësi e subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi nëse janë rrezikuar apo cenuar të drejtat e qytetarëve është arsyetim subjektiv dhe jo kriter cilësor për vlerësim.

36.10. Gjithashtu, arsyetimi se subjekti ka rrëzuar mangësitë procedurale për konstatimin e mungesës së vendimeve të ndërmjetme dhe urdhrave për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e gjykimeve, duke pranuar pretendimin e tij se ato gjejnë pasqyrim në procesverbalet gjyqësore, bie ndesh me nenet 25/2 dhe 27, të ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar.

36.11. Këto dy dispozita janë mjaft të qarta në rregullimin e veprimtarisë gjyqësore me qëllim zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Rëndësia e vendimeve të ndërmjetme dhe urdhrave të gjykatës nuk mund të zëvendësohen nga procesverbali gjyqësor duke i konsideruar ato si të panevojshme.

36.12. Në lidhje me referencat e gabuara ligjore nga ana e subjektit në gjykimin e çështjeve, pretendimi duke referuar Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr. 3/2012, nuk qëndron. Ky vendim nuk mund të konsiderohet se gjen vend në interpretimin e situatës ligjore të pretenduar nga subjekti, në lidhje me mangësitë e konstatuara. Ky vendim është dhënë nga Gjykata për efekt të njehsimit të praktikës gjyqësore, në lidhje me pyetjet vijuese:

“- Cili është roli që duhet të luajë gjykata, veçanërisht në procesin e identifikimit të objektit të mosmarrëveshjes që duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë, pa cenuar të drejtën e disponimit të palëve që e kanë venë atë në lëvizje?

- A duhet të lidhet përgatitja dhe më pas gjykimi e zgjidhja e çështjes vetëm mbi atë që formalisht shkruhet dhe që në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë emetohen si “objekt i padisë” dhe “baza ligjore”?”.

36.13. Duke referuar këtë vendim, subjekti i rivlerësimit nuk justifikohet mbi mospërputhjet e konstatuara midis pjesës hyrëse dhe asaj arsyetuese të vendimit gjyqësor të dhënë prej tij, pra referimit të gabuar të bazës ligjore midis arsyetimit me atë të dispozitivit të vendimit. Në këtë rast, standardi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore është pjesë e garancisë për një proces të rregullt ligjor, qëndrim i mbajtur ky nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese²⁰.

36.14. Vendimi duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke treguar qartësi në strukturën e vendimit, midis pjesës hyrëse, arsyetuese dhe përfundimit. “Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka interpretuar se... “në këtë drejtim vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar

²⁰ Vendim i Gj. Kushtetuese nr. 28, datë 30.3.2017, prg. 17-18 i vendimit.

si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese)”.

36.15. Në lidhje me mangësinë për mos respektimin e afatave ligjore të gjykimit, Komisioni pajtohet me qëndrimin e subjektit²¹ duke arsyetuar se ai ka detyrim të respektojë kërkesat e ligjit nr. 49/2012, i cili nuk parashikon ndonjë afat konkret, por kërkon gjykimin brenda një afati të arsyeshëm.

36.16. Ndërkohë, afati 1-mujor përcaktohet në aneksin nr.1 të vendimit nr. 26/1 të KLD-së, të vitit 2010, kriter ky mbi të cilin janë hartuar të gjitha raportet e vlerësimit profesional nga ana e ILD-së për qëllim të procesit të rivlerësimit²².

37. Për më tepër, arsyetimi i Komisionit në këtë rast se është e vërtetë “*që shtyrja e afateve gjatë gjykimit të çështjeve... mund të konsiderohet e barasvlershme me “mosdhënien e drejtësisë”, por.. nga vlerësimi tërësor i procedurave.., pasurisë dhe figurës nuk vërtetohet ky paralelizim të jetë i vërtetë...Përpos kësaj mosdhënia e drejtësisë do të kishte reflektuar sadopak në vlerën pasurore të aseteve të tij, etikën apo pastërtinë e figurës..”* nuk qëndron. Siç theksuam më lart, secili kriter ka peshë të barabartë në procesin e rivlerësimit dhe rezultatet në vlerësimin e njërit kriter jo domosdoshmërisht duhet të konsiderohet se ndikojnë në vlerësimin e kritereve të tjera, në sensin negativ apo pozitiv ato qofshin.

38. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, rrëzimin e gjetjeve për kriterin profesional, duket sikur shumica e trupit gjykues, në arsyetim aplikon një “mbivendosje mekanike” të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016, pa identifikuar dhe marrë parasysh si bazë vlerësuese asnjë indikator apo kriter matës objektiv, fakt i cili nxjerr në pah nevojën e përcaktimit të një metodologjie, “model”, njësie matëse në funksion të qëllimit të nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

39. Ashtu siç edhe ligjvënësi e ka konceptuar ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit duhet të bazohet në një metodologji dhe procedura standarde konkrete²³, ku përveç respektimit të të drejtave procedurale të subjektit, rezultati synon garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës.

40. Në përcaktimin e metodologjisë dhe standardet e rivlerësimit për kriterin profesional, për aq sa gjejnë zbatim, duhet t’u referohemi kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, por jo duke i vlerësuar ato në mënyrë të përgjithshme dhe automatike, pa përcaktuar një sistem matës objektiv, ashtu siç Komisioni ka vepruar në rastin konkret. Në të kundërt, do të ishte e paqartë dhe jo bindëse hapësira vlerësuese e këtij kriteri apo vija ndarëse midis objektivizmit dhe subjektivizmit në vlerësim.

41. Praktika e deritanishme, ka treguar se rivlerësimi i kriterit profesional ndaj subjekteve ka gjetur një trajtim të përgjithshëm, nga ana e organit kushtetues, Komisionit, duke u bazuar kështu kryesisht në përfundimet e raporteve të hartuara nga Inspektorati, që shumicën e rasteve kanë një qasje jo të detajuar në trajtimin e kritereve të vlerësimit, duke u prirur të jenë pozitive,

²¹ Subjekti shprehet se afati 30-ditor, specifikuar në nenin 327 të K.Pr. Civile është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar.

²² Referuar nenit 160, pika 1, germa “dh”, dhe neni 173, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 96/2016.

²³ Referuar nenit 1 dhe nenit 2, pika 2 e ligjit.

duke vështirësuar një optikë objektive të vlerësimit të aftësive profesionale për qëllim të procesit të rivlerësimit.

42. Për më tepër në rastin konkret, siç u tha, dy raportet e Inspektoratit, janë kundërshtues edhe të vetë njëri-tjetrit në lidhje me kriterin matës, atë të respektimit të afateve të gjykimin nga ana e subjektit të rivlerësimit²⁴ dhe nuk pasqyrojnë të gjitha mangësitë në aspektin profesional, të dala nga hetimi administrativ²⁵.

43. Kjo situatë aktuale e vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit do të vijojë të jetë e pandryshueshme, duke vënë në dyshim efektivitetin e kontrollit të aftësive profesionale, nëse modeli vlerësues i zgjedhur nga institucionet e rivlerësimit, do të vijojë të bazohet vetëm në referencë të përgjithshme të neneve 72 dhe 74, të ligjit nr. 96/2016, pa një metodologji konkrete dhe indikatorë përcaktues dhe të matshëm të meritës profesionale për subjektet e rivlerësimit që do të konfirmohen në sistemin e drejtësisë.

44. Pasojë e këtij modeli të zgjedhur, në rastin konkret Komisioni, referuar mangësive të konstatuara në 13 çështjet e gjykuara nga subjekti (f. 22 e vendimit), i ka vlerësuar ato duke u bazuar në mënyrë të përgjithshme në nenet 72-74 të ligjit nr. 96/2016, duke pranuar të gjitha pretendimet e subjektit rreth mangësive të gjetura²⁶, si dhe duke vlerësuar se për nenet 75 dhe 76 të ligjit nuk kanë rezultuar të dhëna negative (f. 30-31). Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit duhet të vlerësohet si “i aftë”, pa marrë parasysh që secili kriter ka indikatorë specifik matës.

45. Në gjykimin e Komisionerit Publik, ky model vlerësimi nuk është i përshtatshëm. Ky model vlerësimi, paraqitet gjeneralist i përgjithshëm dhe me shumë elemente subjektive në përmbajtjen e tij. Këto elemente që evidentohen në këtë lloj modeli të përdorur, vënë në pikëpyetje dhe rezultatin përfundimtar. Siç u tha më lart, kjo lloj qasje mund të rezultojë efektive vetëm për raste të qarta dhe flagrante, për të cilat mund të prodhohë një rezultat të kundërt nga vlerësimi i subjektit si “i aftë”.

46. Si rrjedhojë, ky lloj modeli vlerësimi rrezikon që të mos kontribuojë në përmirësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit dhe të përmbushë qëllimet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 86/2014.

47. Në këtë kontekst, do të ndodheshim përballë faktit se për efekt të procesit të rivlerësimit, neni 44, germa “b” dhe “c”, në lidhje zbatimin e nenit 60 dhe 61/4 të ligjit nr. 84/2016, ku materializohet përmbajtja e dispozitës së nenit E, të aneksit të Kushtetutës, ka pak gjasa për të gjetur zbatim.

²⁴ Raporti i parë referon afatin 1-mujor, si standardin kohor të punës që gjyqtari duhet të realizojë gjykimin e çështjes (sipas aneksit 1, “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” bashkëlidhur vendimit nr.***, dt.***.4.2010 i KLD-së), ndërkohë raporti i dytë referon se ligji nr. 49/2012, i ndryshuar, nuk parashikon afat për përfundimin e gjykimeve administrative dhe se subjekti i ka gjykuar çështjet në respektim të standardit “gjykim brenda një afati të arsyeshëm”.

²⁵ Gjithashtu sqarojmë se lidhur me tri çështjet e përzgjedhura nga subjekti, Inspektorati ka vlerësuar vetëm vendimet gjyqësore, pa marrë në konsideratë dosjet gjyqësore respektive.

²⁶ Mosrespektim i afateve ligjore në gjykimin e çështjeve, parregullsi në kryerjen e veprimeve procedurale për thirrjen dhe shtyrjen e seancave përgatitore dhe ato gjyqësore, mosnxjerrjen e vendimeve të ndërmjetme, parregullsi në njoftimin e palëve gjyqësore, mungesa e procesverbaleve, referencat e gabuara ligjore etj.

48. Referuar opinionit të Komisionit të Venecias²⁷ dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese²⁸, përsërisim se procesi i rivlerësimit duhet të synojë reformimin e përhershëm të sistemit të drejtësisë, proces ky i përcaktuar në nivel kushtetues dhe i shoqëruar me masa të caktuara mbrojtëse procedurale, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe pastrimin e sistemit nga ata që janë të paaftë, të korrumpuar ose të lidhur me krimin e organizuar. Për këtë qëllim, organet rivlerësuese (KPK dhe KPA) kanë kompetencat e mjaftueshme ligjore për kontrollin dhe rivlerësimin e secilit kriter, pa u lidhur kështu me raportet e organeve ndihmëse.

49. Krahasimisht me kompetencat e këtyre dy organeve (KPK dhe KPA), Komisioneri Publik nuk mund të kryejë hetimin dhe rivlerësimin e kriterit profesional apo kriterëve të tjera, por mund të shprehet e sugjerojë nëpërmjet mjetit procedural të ankimit, me qëllim që procesi i rivlerësimit të kryhet në përputhje me kuadrin kushtetues e ligjor në fuqi. Të ndërgjegjshëm se rivlerësimi i aftësive profesionale, është kriter mjaft i rëndësishëm dhe me efekte të drejtpërdrejta e afatgjate në interesin e publikut, një metodologji efektive dhe objektive do të ndihmonte në rivlerësimin e këtij kriteri.

A.1.3 Metodologjia e rivlerësimit të aftësisë profesionale

50. Komisioneri Publik, në referencë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, që i njihen Kolegjit të Apelimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, veçanërisht në orientimin e praktikës së Komisionit në çështje të ngjashme (neni 66/2 i ligjit nr. 84/2016), vlerëson se nëpërmjet këtij ankimi të parashtrijë një metodologji në lidhje me vlerësimin e burimeve të aftësisë profesionale për subjektet, në kuadër të zbatimit të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

51. Kjo metodologji që po parashtrihet për vlerësimin e Kolegjit në këtë ankim, është produkt i vlerësimit që Komisioneri Publik i ka bërë rekomandimit të komisionit të përfaqësuesve të ONM për çështjen konkrete, por vjen njëkohësisht edhe si rezultat i bindjes së Komisionerit Publik, se ajo përmban një qasje të përshtatshme në lidhje me përcaktimin e indikatorëve objektivë për vlerësimin e kriterëve të vlerësimit profesional, të parashikuar nga ligji nr. 96/2016.

52. Kjo metodologji, referuar përmbajtjes së neneve 71, 72, 74, 75, 76, të ligjit nr. 96/2016, në rastet e magjistratëve/gjyqtarë, përkthen kriteret e rivlerësimit dhe elementët referues të tyre, në indikatorë. Këta indikatorë do të duhet të jenë të matshëm për çdo burim informacioni që ligji parashikon, rast pas rasti, për të arritur në një përfundim që lidhet me konfirmimin ose jo të subjekti, ose konstatimin e mangësive të tij, në kuadër të rivlerësimit kalimtar.

53. Duke kryer një vlerësim të tillë, mbi bazën e indikatorëve cilësorë dhe sasiorë, të matshëm, do të bëhet e mundur një qasje përfundimtare sa më objektive për subjektet e rivlerësimit, e cila, edhe pse edhe në këtë rast, në mënyrë të pashmangshme, përmban elementë subjektivë, do të garantojë standarde më të larta, sesa qasja e përgjithshme që duket se po përdoret deri më tani nga institucionet e rivlerësimit, për vlerësimin e aftësive profesionale.

54. Metodologjia e propozuar për t' u përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale përkthen përdorimin e katër kriterëve të vlerësimit profesional të parashikuar në nenin 71, të ligjit nr. 96/2016 si indikatorë. Pra do të kemi në këtë metodologji katër indikatorë:

²⁷ CDL-AD (2015) 045 dhe CDL-AD (2016) 009.

²⁸ Vendimi nr. 2, 34 dhe 78 i vitit 2017.

- i) aftësitë profesionale;
- ii) aftësitë organizative;
- iii) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- iv) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Në bazë të kësaj metodologjie, secili nga këta katër indikatorë zërthehet në nënindikatorë dhe çdo nënindikator përmban në vetvete elemente që shërbejnë për matjen e tyre.

54.1. Kështu, aftësia profesionale e magjistratit/gjyqtar, neni 71/a përcaktohet në nënkriteret e nenit 72, të përkthyer në nënindikatorë me elementet përkatëse:

54.1.1 Njohuritë ligjore, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elementë: a) aftësitë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, në konsideratë të treguesve të tillë si a.1) aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, a.2) identifikimin e konfliktit të normave, a.3) për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe a.4) aftësinë për të analizuar jurisprudencën;

54.1.2 Arsyetimi ligjor, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elemente: a.1) qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, a.2) struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe a.3) cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.

54.2. Aftësia organizative, nenin 71/b, përcaktohet në nënkriteret e nenit 74, të përkthyer në nënindikatorë me elementet përkatëse:

54.2.1. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elemente: a.1) respektimi i afateve ligjore, a.2) plotësimi i standardeve minimale kohore, a.3) koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje dhe a.4) koha mesatare për marrjen e vendimit;

54.2.2 Aftësia për të kryer procedura gjyqësore, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elemente: a.1) numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje, a.2) kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, a.3) mbikëqyrja e kryerjes së akteve të nevojshme të njoftimit, a.4) qenia e plotë dhe paraqitja e rregullt e dosjes, a.5) dokumentacioni i mbajtur me kujdes.

54.3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, neni 71/c, përcaktohet në nënkriteret e nenit 75, të përkthyer në nënindikatorë me elementet përkatëse:

54.3.1. Etika në punë, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elemente: a.1) ankesat dhe rezultati i verifikimit të tyre, a.2) mendimi i kryetarëve të gjykatave, dhe a.3) vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të rivlerësimit.

54.3.2 Integriteti, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elemente: a.1) ankesat dhe rezultati i verifikimit të tyre, a.2) mendimi i kryetarëve të gjykatave, dhe a.3) vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të rivlerësimit. dhe/ose raportet e ILKPDIK-së.

54.3.3 Paanësia, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elemente: a.1) përdorimi i gjuhës diskriminuese, a.2) numër mjaft i lartë i kërkesave të palëve për përjashtimin e magjistratit/gjyqtar, si dhe a.3) tregues nga burime të tjera vlerësimi.

54.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, neni 71/ç, përcaktohet në nënkriteret e nenit 76, të përkthyer në nënindikatorë me elementet përkatëse:

54.4.1 Aftësia e komunikimit, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elemente: a.1) komunikim i qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjekte të tjera, të tretë, në a.2) respektim i konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale;

54.4.2 Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria për t'u angazhuar, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elementë: a.1) komunikimi dhe ndërveprimi me kolegët ose administratën gjyqësore, a.2) shkëmbimi i njohurive profesionale dhe eksperiencës;

54.4.3 Administrimi i dosjeve gjyqësore, nënindikator që vlerësohet duke u bazuar në këto elementë: a.1) pjesëmarrja e në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ose pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, etj. a.2) gatishmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, a.3) pjesëmarrja në veprimtari ndër-institucionale ose veprimtari të gjykatës me publikun, a.4) publikime shkencore.

55. Në zbatim të kësaj metodologjie, vlerësimi i kriterëve, duke i përkthyer në indikatorë, nënindikatorë, me elementët përkatës, kryhet duke identifikuar për çdo burim vlerësimi gjetjet pozitive dhe negative, duke i dhënë njëkohësisht një vlerë të matshme konkrete (+/-).

55.1 Pas vlerësimit të secilit indikator, sipas tabelës të pasqyruar në opinionin e ONM-së, si dhe në aneksin e këtij ankimi, do të mund të kalohet në vlerësimin përfundimtar të përbashkët të kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, me qëllim përcaktimin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit me një nga tre kategoritë që parashikon neni 44 i ligjit, nr. 84/2016.

56. Kjo metodologji, do të ndihmonte institucionet e rivlerësimit, posaçërisht, Komisionin, që edhe raportet e ardhura nga organet ndihmëse, të mund t'i përfshijë dhe t'i bëjë pjesë të vlerësimit në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016, por mbi bazën e një metodologjike të vetën, objektive, transparente dhe të matshme për çdo subjekt rivlerësimi.

57. Në qoftë rivlerësimi profesional do të kryhej mbi bazën e kësaj metodologjie, edhe në rastin konkret, secili kriter ligjor i vlerësimit do të mund të merrte peshën e tij specifike për të 13 rastet e shqyrtuara, ku të identifikohesh me vlerësim pozitiv apo negativ, duke prodhuar një rezultat final për subjektin nën rivlerësim.

58. Sa më sipër, për subjektin z. Medja, vlerësimi i Komisionit për kriterin profesional ka qenë i përgjithshëm dhe pa u bazuar në një metodologji objektive, pasi në të nuk gjejmë trajtim dhe vlerësim të gjitha nënkriteret e përcaktuara në nenet 72-76 të ligjit nr. 84/2016, paraqitur në formë tabelore sipas aneksit bashkëlidhur këtij ankimi. Në këto kushte vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja është i mangët.

59. Efektiviteti i sistemit gjyqësor kërkon që gjyqtarët të kenë një shkallë të lartë të vetëdijes profesionale, ku njësisia matëse për cilësinë dhe sasinë e punës së tyre individuale duhet të vlerësohet në bazë të kriterëve sasiorë e cilësorë objektive, kriterë këto të cilat i përkasin sistemit formal të vlerësimit.

60. Kjo metodologji vlerësimi propozohet duke mbajtur në konsideratë fakti se, kriteret për vlerësimin e performancës profesionale të subjekteve duhet të jenë të larmishme dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim që të mundësohet një vlerësim i plotë dhe i thellë i performancës profesionale të gjyqtarëve²⁹.

61. Përmbajtja e kësaj metodologjie referon në përmbajtje edhe parimet e Opinionit 17 (2017³⁰) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë të KE-së (KKGJE/CCJE) për vlerësimin e punës së gjyqtarit, cilësinë e drejtësisë dhe respektin për pavarësinë gjyqësore. KKGJE i ka kushtuar vëmendje të vazhdueshme dy çështjeve themelore, së pari, mbrojtja e pavarësisë së gjyqësorit dhe së dyti mënyrat e ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të sistemeve gjyqësore, ku vendoset theksi në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të sistemeve gjyqësore në interes të të gjithë qytetarëve... *“aty ku ekziston, vlerësimi individual i gjyqtarëve duhet të synojë përmirësimin e gjyqësorit, duke siguruar cilësinë më të lartë të mundshme. Ky ushtrim duhet të bëhet në interes të publikut në tërësi”*³¹.

62. Në përfundim të sa më sipër, e vlerësojmë të nevojshme mundësinë që bazuar në nenin 66/2 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji t'i rekomandonte Komisionit në formën e një orientimi mënyrën e rivlerësimit të aftësisë profesionale, duke i dhënë këtij kriteri peshën e duhur në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në funksion të qëllimit kushtetues e ligjor që ka ky proces.

63. Në rastin konkret, vlerësimi i mangësive të konstatuara nga shqyrtimi i 13 çështjeve të vlerësuara për z. Gentian Medja, në rast se do të pranohej të kryhej mbi bazën e kësaj metodologjie të propozuar, në kushtet ku subjekti i rivlerësimit në të gjitha rastet shfaq të njëjtat problematika, duke krijuar kështu një *“model të metash”*, që nuk kanë vetëm një karakter të izoluar apo rastësor, mund të sjellin një përfundim të ndryshëm në lidhje me konfirmimin e subjektit.

V. Kërkimi i ankimit

64. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, neneve C/2, E dhe F/7 të aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se hetimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për kriterin e aftësisë profesionale, referuar gjendjes së akteve dhe procedurave, nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, bazuar në dispozitën e nenit 44/1 dhe 59/1, c të ligjit nr. 84/2016.

65. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me

²⁹ Rrjeti Evropian i Këshillave për gjyqësorin-ENCJ 2012-2014.

³⁰ Ky opinion është përgatitur në bazë të opinionëve të mëparshme të KKGJE-së dhe Magna Carta të Gjyqtarëve (2010) dhe instrumenteve përkatëse të Këshillit të Evropës, Statuti i Gjyqtarëve (1998) dhe Rekomandimi (CM/Rec (2010) 12) i Komitetit të Ministrave për gjyqtarët-pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë (2002), Raporti i Përgjithshëm i Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve (IAJ-2006), Raporti i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit (1985); Rekomandimet e Kievit (OSBE-së) për Pavarësinë Gjyqësore në Evropën Lindore, Kaukazin e Jugut dhe Azinë Qendrore (2010) dhe Raporti i 2012-2013, i Rrjetit Evropian i Këshillave Gjyqësor (ENCJ) për standardet minimale në lidhje me vlerësimin e performancës ...

³¹ Opinioni 17(2014) CCJE, prg. 7.

ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt.

66. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të zbatojë kompetenca që Kushtetuta dhe ligji ia japin dy institucioneve të rivlerësimit, Kolegjit dhe Komisionit;

67. Referuar pikës 3, të nenit F të aneksit të Kushtetutës ku sanksionohet se: “3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj.”;

68. Referuar pikës 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016 ku sanksionohet se: “2. Kolegji i Apelit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme”.

69. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, dhe vetëm pasi të ketë kryer vetë Kolegji një hetim në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja, mbështetur në metodologjinë e paraqitur në këtë ankim dhe rekomandimin e ONM-së, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 60, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

I bashkëlidhen këtij ankimi dhe janë pjesë e tij:

1. Aneks (Tabela e indikatorëve të metodologjisë së vlerësimit të aftësisë profesionale);
2. Rekomandim nr.*** prot., datë 9.8.2018, i ONM-së (përfshirë Opinionin nr.*** prot., datë 12.7.2018, të vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, përcjellë Komisionit);
3. Addendum i rekomandimit, nr.*** prot., datë 13.9.2018, i ONM-së.